

"Me Sytë e Fëmijës"



SHËRBIMI I PROVËS



Terre des hommes

Ndihmë për fëmijët.

**Hulumtim Pjesëmarrës mbi Perceptimin e
Fëmijëve në Konflikt me Ligjin për Efektivitetin
dhe Ndikimin e Shërbimit të Provës në
Riintegrimin e Tyre në Shoqëri**

Terre des hommes Shqipëri
në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës

Qershor 2022

Studiues:

Zsuzsanna Rutai, PhD, Konsulente ndërkombëtare
Zhaklina Peto, Prof. Dr., Konsulente
Klodian Gega, Konsulent

Grupi i punës:

Dafina Kelmendi
Dr. Enkeleda Sako
Elvis Mancellari
Kaltrina Hyka
Mehmet Durishti
Nadjuska Çela
Sonila Muzhaqi
Valmira Greca

Falenderojmë veçanërisht për mbështetjen në realizimin e këtij studimi Z. Ervin Hoxha, Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, dhe Znj. Erlinda Murati Plyku , MA, Specialiste në DPShP.

Gjithashtu falenderim dhe mirënjohje të veçantë për të gjithë të miturit në konflikt me ligjin të cilët ndanë me zemërgjerësi mendimet dhe përvojën e tyre gjatë rrugëtimit në Shërbimin e Provës.

Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit “ Riintegrimi i të miturve në konflikt me ligjin”

Botuar nga : Terre des hommes, Misioni në Shqipëri
Copyright © Terre des hommes Misioni në Shqipëri, 2022

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e autorëve dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht opinionin e Terre des hommes dhe Shërbimit të Provës.

1. HYRJE	4
1.1. Qëllimet e hulumtimit.....	4
1.2. Kuadri ndërkombëtar dhe kombëtar i drejtësisë penale për fëmijët me fokus te shërbimet e provës.....	5
1.3. Kuadri institucional dhe rregullat e personelit të Shërbimit të Provës në Shqipëri.....	10
1.4. Shërbimi i provës për fëmijët në konflikt me ligjin në Shqipëri.....	11
1.5. Shërbimi i provës për fëmijët në konflikt me ligjin sipas shifrave.....	14
2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	16
2.1. Mbrojtja e fëmijëve gjatë hulumtimit.....	16
2.2. Zbatimi i hulumtimit.....	17
2.3. Profili i pjesëmarrësve.....	18
3. PERCEPTIMI I FËMIJËVE NË KONFLIKT ME LIGJIN PËR EFEKTIVITETIN DHE NDIKIMIN E SHËRBIMIT TË PROVËS NË REHABILITIMIN E TYRE	21
3.1. E drejta e pjesëmarrjes.....	21
3.2. Interesi më i mirë i fëmijës dhe e drejta e zhvillimit harmonik.....	24
3.3. Mbrojtja nga diskriminimi.....	25
3.4. Respekti për dinjitetin dhe mbrojtja e privatësisë së fëmijës.....	26
3.5. Ekzaminim i shpejtë me preferencë dhe pa vonesa të panevojshme.....	28
3.6. Elementet e procesit të rregullt.....	28
4. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	30
Shtojca 1. Pyetjet hulumtuese: zbatimi i parimeve të drejtësisë miqësore ndaj fëmijëve në shërbimet e provës.....	34

1. HYRJE

1.1. Qëllimet e hulumtimit

Pavarësisht nga rrethanat, kontakti me sistemin e drejtësisë penale është një përvojë traumatike për një fëmijë, ndërsa ata fëmijë që shkelin ligjin shpesh vijnë nga një mjedis vulnerabël. Për të ofruar shërbime ligjore cilësore dhe efektive për ta, Shqipëria ka hartuar një kuadër institucional dhe ka vendosur bashkëpunim ndërsektorial mes strukturave të sistemit të drejtësisë dhe pushtetit vendor. Institucioni që ka një kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim është Shërbimi i Provës. Ai nisi të funksionojë në vitin 2009, më pas, në vitin 2018, u ngarkua me mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të masave të shmangies dhe dënimeve alternative për fëmijët në konflikt me ligjin. Deri tani cilësia e shërbimeve dhe performanca e institucionit janë vlerësuar duke përdorur metoda tradicionale, duke përjashtuar një grup të rëndësishëm përfituesish: fëmijët. Mungesa e pjesëmarrjes së fëmijëve në vlerësimin e shërbimeve të provës jo vetëm që e pengon institucionin të identifikojë dhe zgjidhë çështje sistematike, por i pengon fëmijët të dëgjohen dhe të ndikojnë në programet dhe shërbimet që kanë një ndikim të rëndësishëm në jetën e tyre.

Duke e njohur këtë hendek, në bashkëpunim të ngushtë me Shërbimin e Provës të Shqipërisë, Terre des Hommes (Tdh) në Shqipëri vendosi të ndërmarrë hulumtime pjesëmarrëse me synimin për të kuptuar perceptimin e fëmijëve në konflikt me ligjin për efektivitetin e Shërbimit të Provës dhe ndikimin në rehabilitimin e tyre. Standardet ndërkombëtare të drejtësisë penale për fëmijët, të garantuara nga Kodi shqiptar i Drejtësisë Penale për të Mitur, shërbyen si bazë e metodologjisë së hulumtimit: e drejta për pjesëmarrje, interesi më i mirë i fëmijës dhe e drejta për zhvillim harmonik, mbrojtja nga diskriminimi, respektimi i dinjitetit dhe mbrojtja e privatësisë së fëmijës, ekzaminimi i shpejtë me preferencë dhe pa vonesa të panevojshme, si dhe elementet e procesit të rregullt ligjor. Gjetjet e hulumtimit, të përmbledhura në këtë studim kërkimor dhe të plotësuara me rekomandime, mund të jenë një mjet i dobishëm për reflektim të mëtejshëm për Shërbimin e Provës, Tdh Shqipëri dhe organizata të tjera të interesuara për të dëgjuar fëmijët.

1.2. Kuadri ndërkombëtar dhe kombëtar i drejtësisë penale për fëmijët me fokus te shërbimet e provës

Duke qenë se Shqipëria është shtet palë e *Konventës për të Drejtat e Fëmijës* (KDF e OKB-së), ajo është e detyruar "të njohë të drejtën e çdo fëmije të pretenduar, të akuzuar ose të njohur se ka shkelur ligjin penal, për t'u trajtuar në përputhje me promovimin e ndjenjës së dinjitetit dhe meritës së fëmijës, çka përforcon respektin e fëmijës për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve dhe merr parasysh moshën e fëmijës dhe dëshirën për të nxitur riintegrimin dhe marrjen e një roli konstruktiv nga fëmija në shoqëri".

¹ *Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, Neni 40 (1).*

Konventa e OKB-së përmend shërbimet e provës si një nga dispozitat që duhen vendosur për të siguruar që fëmijët në konflikt me ligjin të trajtohen në një mënyrë të përshtatshme për mirëqenien e tyre dhe në përpjesëtim me rrethanat dhe me shkeljen e kryer prej tyre².

Në Komentin e Përgjithshëm nr. 24, Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve rekomandon që “shtetet palë duhet të kenë në funksion një shërbim prove ose agjenci të ngjashme, me staf të trajnuar mirë, për të siguruar përdorimin maksimal dhe efektiv të masave të tilla si udhëzimet dhe urdhrat mbikëqyrës, lirimi me kusht, monitorimi në komunitet ose qendrat e raportimit ditor, si dhe mundësinë e lirit të parakohshëm nga paraburgimi³”. Për më tepër, komenti thekson se “shërbimet e specializuara si shërbimi i provës, këshillimi ose mbikëqyrja duhen ngritur së bashku me mjedise të specializuara, për shembull, qendrat e trajtimit ditor dhe, aty ku është e nevojshme, mjedise në shkallë të vogël për kujdesin rezidencial dhe trajtimin e fëmijëve të referuar nga sistemi i drejtësisë për fëmijë. Koordinimi efektiv ndërinstucional i aktiviteteve të të gjitha këtyre njësive, shërbimeve dhe mjediseve të specializuara duhet promovuar vazhdimisht⁴”.

Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (të ashtuquajturat “Rregullat e Pekinit”)⁵ bëjnë thirrje për marrjen në konsideratë të shmangies, që do të thotë se autoriteti kompetent duhet të merret me fëmijët shkelës pa iu drejtuar gjykimit formal, duke përfshirë largimin nga procesi i drejtësisë penale, mbikëqyrjen dhe udhëzimin e përkohshëm dhe ridrejtimin të shërbimeve mbështetëse të komunitetit (Rregulli 11). Rregullat e Pekinit e renditin shërbimin e provës si një nga masat alternative të zgjidhjes, vendosur nga një autoritet kompetent në mënyrë fleksibël, për të shmangur sa më shumë institucionalizimin (Rregulli 18). Fëmijëve në konflikt me ligjin duhet t’u sigurohet gjithë ndihma e nevojshme për të lehtësuar procesin e rehabilitimit (Rregulli 24).

Standardet evropiane të drejtësisë për fëmijët – që mbulojnë gjithë fushat e drejtësisë, duke përfshirë procedurën penale – përcaktohen nga *Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Drejtësinë Miqësore për Fëmijët*. Ky dokument i ligjit të butë e përkufizon drejtësinë miqësore për fëmijët si “sisteme që garantojnë respektimin dhe zbatimin efektiv të të gjitha të drejtave të fëmijëve në nivelin më të lartë të arritshëm, duke pasur parasysh parimet e renditura më poshtë dhe duke i kushtuar vëmendjen e duhur nivelit të pjekurisë dhe mirëkuptimit të fëmijës, si dhe rrethanave të rastit.

² *Ibid.* Neni 40 (4).

³ Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, *Komenti i Përgjithshëm Nr. 24 (2019) mbi të drejtat e fëmijëve në sistemin e drejtësisë për fëmijë*, CRC/C/GC/24, 18 shtator 2019, para. 19, gjendet në: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRC%2fC%2fGC%2f24&Lang=en

⁴ *Ibid.* para. 108.

⁵ *Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit* (“Rregullat e Pekinit”), miratuar me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 40/33 të 29 nëntorit 1985, gjendet në: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/united-nations-standard-minimum-rules-administration-juvenile>

Është, në veçanti, drejtësia që është e arritshme, e përshtatshme për moshën, e shpejtë, e zellshme, e përshtatur dhe e përqendruar te nevojat dhe të drejtat e fëmijës, duke respektuar të drejtat e tij, përfshirë të drejtat për një proces të rregullt ligjor, për të marrë pjesë dhe për të kuptuar procedurat, për respektimin e jetës private dhe familjare, si dhe të integritetit dhe dinjitetit⁶". Në lidhje me masat dhe sanksionet për fëmijët në konflikt me ligjin, Udhëzimet theksojnë se ato duhet të jenë përgjigje konstruktive dhe individuale ndaj veprimeve të kryera, duke marrë parasysh parimin e proporcionalitetit, moshën e fëmijës, mirëqenien dhe zhvillimin fizik dhe mendor, si dhe rrethanat e çështjes, duke garantuar të drejtën për rehabilitim dhe riintegrim⁷.

Një rekomandim tjetër nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, *Rregullat evropiane të shërbimit të provës* i përkufizon agjencitë e provës si organe të përcaktuara me ligj për të zbatuar sanksionet dhe masat e përcaktuara me ligj dhe të vendosura ndaj një shkelësi. Ai përfshin një sërë aktivitete dhe ndërhyrjesh, të tilla si mbikëqyrja, udhëzimi dhe ndihma që synojnë përfshirjen sociale të shkelësit, si dhe kontributin në sigurinë e komunitetit⁸. Për më tepër, rregullat evropiane të shërbimit të provës parashtrajnë dispozita të përgjithshme në lidhje me strukturën, statusin dhe burimet e agjencive të provës, menaxhimin e marrëdhënieve me autoritetet e tjera kompetente, elementët e punës së provës, si dhe fazat e procesit të mbikëqyrjes.

Udhëzimet në lidhje me rekrutimin, përzgjedhjen, edukimin, trajnimin dhe zhvillimin profesional të personelit të shërbimit të provës miratuar nga Komiteti Evropian për Problemet e Krimin theksojnë se: "procedurat e veçanta të rekrutimit dhe përzgjedhjes për personelin që punon me të mitur duhet të funksionojnë duke marrë parasysh cilësitë dhe kualifikimet profesionale të nevojshme për të punuar me të miturit dhe familjet e tyre⁹". Në lidhje me një shërbim prove efikas dhe efektiv për fëmijët në konflikt me ligjin, Udhëzimet rekomandojnë që "duke njohur nevojat e ndryshme të fëmijëve dhe të rinjve duhet ofruar një trajnim specifik për oficerët e provës që punojnë me këtë grup. Një trajnim i tillë duhet të jetë i informuar nga parimet e të drejtave të fëmijëve, duke përfshirë përparësinë e mirëqenies së fëmijës dhe faktin që fëmijët duhet të dëgjohen për çështje që i prekin ata¹⁰".

Për sa i përket kuadrit kombëtar, Kushtetuta e Shqipërisë deklaron se fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën e mbrojtjes së veçantë nga shteti dhe çdo fëmijë ka të drejtën të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe kryerja e çdo pune, veçanërisht nën moshën minimale të punës për fëmijët, e cila mund të dëmtojë shëndetin dhe moralin e tyre, si dhe të rrezikojë jetën ose zhvillimin normal të tyre¹¹. Këto dispozita kushtetuese janë marrë në konsideratë gjatë hartimit dhe shqyrtimit të të gjitha akteve ligjore që lidhen me fëmijët në konflikt me ligjin, me referencë të veçantë për fëmijët mbi moshën e përgjegjësisë penale, siç është Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Republikën e

⁹Udhëzime në lidhje me rekrutimin, përzgjedhjen, edukimin, trajnimin dhe zhvillimin profesional të personelit të burgjeve dhe shërbimit të provës, përshtatur nga Komiteti Evropian për Problemet e Krimin (CDPC) 2019, para. 4(c). gjendet në: <https://rm.coe.int/guidelines-training-staff/1680943aad>

¹⁰*Ibid.* Shtojca ii: Matrica e arsimit dhe trajnimit të agjencive të shërbimit të provës.

¹¹Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 54 (1)-(3).

Shqipërisë, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, legjislacioni për shërbimin social dhe Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Provës.

Ligji Nr. 18/2017 për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Republikën e Shqipërisë deklaron parimet themelore të politikave kombëtare që lidhen me të drejtat e fëmijës, mekanizmat efektivë dhe autoritetet përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për të garantuar ushtrimin efektiv, respektimin dhe promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës. Ai kërkon bashkëpunim brenda strukturave dhe mes autoriteteve përgjegjëse, për më tepër me organizatat që operojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës¹². Ai e njeh fëmijën si mbajtës të së drejtës dhe çdo e drejtë që i vërtetohet fëmijës i korrespondon detyrimit specifik të autoriteteve shtetërore. Ligji parashikon një sistem të integruar dhe funksional të mbrojtjes së fëmijëve, i cili parandalon dhe i përgjigjet në mënyrë efektive të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhencës ndaj fëmijëve – përfshirë fëmijët në konflikt me ligjin, të cilët përkufizohen si fëmijë që kanë nevojë për mbrojtje të veçantë.

Kodi shqiptar i Drejtësisë Penale për të Mitur (Kodi i Drejtësisë për të Mitur) garanton kuadrin ligjor për drejtësinë e fëmijëve në përputhje me standardet ndërkombëtare, promovon riintegrimin e fëmijëve në konflikt me ligjin dhe siguron risocializimin dhe rehabilitimin e tyre¹³. Kodi zbatohet për fëmijët mbi moshën e përgjegjësisë penale, 14 deri në 18 vjeç, dhe në disa raste, për të rinjtë nga 18 deri në 21 vjeç¹⁴. Dispozitat e *Kodit Penal* dhe *Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë* zbatohen për drejtësinë penale të fëmijëve vetëm nëse çështja nuk rregullohet nga Kodi i Drejtësisë për Fëmijët ose nëse përmbajnë rregulla më të favorshme për fëmijët¹⁵. Në të njëjtën kohë, fëmijët në konflikt me ligjin gëzojnë të gjitha të drejtat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe të drejtat e veçanta të parashikuara në Kodin e Drejtësisë për Fëmijë¹⁶.

Parimet udhëzuese të Kodit të Drejtësisë për Fëmijët janë si më poshtë (Kapitulli 2):

- Interesi më i mirë i fëmijës dhe e drejta për zhvillim harmonik,
- Pjesëmarrja,
- Respektimi i dinjitetit dhe mbrojtja e privatësisë së fëmijës,
- Mbrojtja nga diskriminimi,
- Ekzaminimi i shpejtë me preferencë dhe pa vonesa të panevojshme,
- Elementet e procesit të rregullt ligjor: prezumimi i pafajësisë, e drejta për gjykim të drejtë, proporcionaliteti, e drejta për ankim dhe e drejta për qasje në mekanizma të pavarur dhe efektivë të ankesës.

Sipas *Ligjit nr. 78/2020 për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Provës* (Ligji për Shërbimet e Provës), misioni i Shërbimit të Provës është promovimi i përfshirjes sociale të personave nën mbikëqyrje – ndaj të cilëve gjykata ka vendosur një nga alternativat e burgut ose ndaj të cilëve gjykata ka vendosur urdhër

¹² *Ligji Nr. 18/2017 për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Republikën e Shqipërisë, Neni 2.*

¹³ *Kodi Shqiptar i Drejtësisë Penale për Fëmijët (Kodi i Drejtësisë për Fëmijët), Neni 2.*

¹⁴ *Ibid. Neni 4 (1)-(2).*

¹⁵ *Ibid. Neni 5.*

¹⁶ *Ibid. Neni 19.*

mbrojtjeje ose ndaj të cilëve është vendosur ndonjë masë tjetër shtrënguese me vendim të gjykatës – me qëllim parandalimin e kryerjes së veprave penale dhe zhvillimin e ndjenjës së përgjegjësisë ndaj shoqërisë dhe viktimës nëpërmjet rregullave të ndërveprimit social dhe ndërhyrjeve të veçanta¹⁷. Gjithashtu, Shërbimi i Provës mbikëqyr zbatimin e vendimeve gjyqësore të shmangies nga ndjekja penale dhe dënimet pa burgim të fëmijëve në konflikt me ligjin, përfshirë ndërmjetësimin¹⁸.

Sipas Kodit të Drejtësisë për Fëmijët, Shërbimi i Provës identifikohet si organ kompetent për administrimin e drejtësisë penale për fëmijët dhe për rrjedhojë i nënshtrohet parimeve të tij¹⁹. Përveç kësaj, Ligji për Shërbimin e Provës thekson se Shërbimi i Provës udhëhiqet nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës dhe i ofron fëmijës ndihmë sociale, edukative, psikologjike, mjekësore dhe fizike në përputhje me nevojat individuale të fëmijës dhe moshën e tij/saj, gjininë dhe personalitetin, me synim rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijës në jetën shoqërore²⁰. Prandaj, kjo pjesë e legjislacionit ka disa dispozita që vendosin rregulla specifike për mbikëqyrjen e fëmijëve.

Drejtësia penale për fëmijë me fokus te shërbimet e provës	
Instrumentet ligjore ndërkombëtare dhe evropiane	Instrumentet ligjore ndërkombëtare dhe evropiane
Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës	Kushtetuta e Shqipërisë
Komenti i përgjithshëm nr. 24 i Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, (2019) mbi të drejtat e fëmijëve në sistemin e drejtësisë për fëmijët	Ligji Nr. 18/2017 për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Republikën e Shqipërisë
Rregullat standarde minimale të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të miturit	Ligji Nr. 37/2017 për Kodin e Drejtësisë Penale për Fëmijët
Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për drejtësinë miqësore me fëmijët	Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale
Rregullat evropiane të shërbimit të provës të Këshillit të Evropës	Ligji Nr. 78/2020 për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës

¹⁷ Ligji për Shërbimet e Provës, Neni 5.

¹⁸ Ibid. Neni 25 (1).

¹⁹ Ibid. Neni 3, pika 15.

²⁰ Ibid. Neni 25 (2).

1.3. Kuadri institucional dhe rregullat e personelit të Shërbimit të Provës në Shqipëri

Sipas *Ligjit për Shërbimet e Provës*, Shërbimi i Provës është një organ publik me seli në Tiranë dhe 22 degë territoriale në nivel vendor. Oficerët e provës janë nëpunës civilë, të cilët kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në psikologji, drejtësi, punë sociale ose sociologji dhe kanë së paku një vit përvojë pune në profesionin e tyre (Neni 12 (2)). Ata rekrutohen me konkurs, në përputhje me *Ligjin Nr. 152/2013 Për Nëpunësin Civil*. Oficerët e provës i nënshtrohen trajnimit të detyrueshëm profesional.²¹ Trajnimi fillestar synon t'u ofrojë atyre "njohuritë e duhura teorike dhe praktike profesionale për mbikëqyrjen e masave alternative, dënimet pa burgim sipas Kodit të Drejtësisë për Fëmijët, alternativat e burgut sipas Kodit Penal, si dhe ndihmën dhe riintegrimin në shoqëri të personave nën mbikëqyrje", ndërsa synimi i trajnimit të vazhdueshëm është përditësimi i njohurive dhe aftësive profesionale në mënyrë që të "përshtaten me zhvillimet e kuadrit ligjor dhe standardeve ndërkombëtare".²²

Oficerët e shërbimit të provës përgjegjës për mbikëqyrjen e fëmijëve në konflikt me ligjin duhet të ndjekin trajnime të vazhdueshme të specializuara për drejtësinë penale të fëmijëve në përputhje me Kodin e Drejtësisë për Fëmijët dhe të trajnohen në mënyrë specifike për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës.²³ Këto tema, ndër të tjera, përfshijnë: metodologjinë e komunikimit me fëmijën, standardet dhe parimet që garantojnë të drejtat e fëmijës, parimet dhe detyrat etike të oficerit të provës, aftësitë dhe teknikat në lidhje me situatat kritike, vlerësimin e rrezikut, referimin e rastit dhe garantimin e parimit të konfidencialitetit, teknikat e intervistës, psikologjia e fëmijës dhe komunikimi me fëmijën në një gjuhë të përshtatshme për të.²⁴ Programi i trajnimit të vazhdueshëm përgatitet nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe përcakton metodat e trajnimit, orarin e trajnimit, modulet dhe kushtet për lëshimin e certifikatës së pjesëmarrjes.²⁵ Vlen të theksohet se në kuadër të Programit trevjeçar shqiptaro-suedez për Drejtësinë për të Miturit,²⁶ 24 oficerë të provës që punojnë me fëmijët u trajnuan mbi kornizat dhe teknikat e intervistimit kognitiv-të sjelljes dhe motivuese, më pas morën këshillim për të siguruar zbatimin e duhur të instrumenteve dhe teknikave, si dhe për të trajtuar vështirësitë praktike.²⁷

²¹ *Programi aktual i trajnimit është publikuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 80, datë 22.02.2022 "Për programet e trajnimit bazë dhe të vazhdueshëm". Shtojca, 1, 2*

²² *Neni 15-17.*

²³ *Kodi i Drejtësisë për Fëmijët, Neni 25- 26.*

²⁴ *Ibid.*

²⁵ *Ibid, Neni 17.*

²⁶ *"Forcimi i kapaciteteve të agjencive ligjzbatuese shqiptare për të përmbushur standardet e të drejtave të njeriut në drejtësinë për të miturit – një qasje që përfshin zinxhirin e drejtësisë". Shih Raportin e Monitorimit të Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit, Ministria e Drejtësisë, janar- qershor 2019, f. 15.*

²⁷ *Almir Xhangolli: Shërbimi i Provës në Evropë, Shqipëri, CEP, Konfederata e Shërbimit Evropian të Provës, 2021, f. 21 gjendet në <https://www.cep-probation.org/wp-content/uploads/2021/11/Chapter-Albania-final-1.pdf>*

Megjithatë, raportohet se trajnimi i vazhdueshëm i specializuar nuk është i mjaftueshëm për ngritjen e kapaciteteve të oficerëve të provës²⁸. Përgjigja e mundshme e shtetit mund të parashikohet falë instrumenteve të ndryshme. Së pari, një nga objektivat specifike të *Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025* është krijimi i një shërbimi efektiv dhe efikas të provës që përdor standardet operacionale, metodologjitë e mbikëqyrjes dhe menaxhimin e rasteve të individualizuara, mbështet risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, punon në përputhje me praktikën dhe standardet më të mira të Bashkimit Evropian dhe pranohet nga gjykatat dhe prokuroria si një alternativë e mirë ndaj burgimit. Për këtë qëllim, duhet të bëhet analiza e nevojave për trajnim të oficerëve të provës dhe për të rritur cilësinë e shërbimeve të ofruara (trajnimi fillestar dhe i vazhdueshëm)²⁹ trajnimi duhet të përgatitet dhe zbatohet në bazë të këtij plani. Së dyti, *Plani i Veprimit 2022-2024 për zbatimin e objektivave strategjike të planit të integritetit të Shërbimit të Provës* parashikon që institucioni është i detyruar të kryejë një analizë të nevojave për trajnim të personelit dhe të vlerësojë ndikimin e trajnimeve të përfunduara, si dhe të hartojë dhe miratojë metodologjinë vjetore të vlerësimit për trajnimet³⁰.

1.4. Shërbimi i provës për fëmijët në konflikt me ligjin në Shqipëri

Në vitin 2018, Kodi i ri i Drejtësisë për Fëmijët e ngarkoi Shërbimin e Provës me mbikëqyrjen e fëmijëve në konflikt me ligjin, subjekt të masave të shmangies dhe sanksioneve alternative, të vendosura nga prokurori ose gjykata. Masat alternative të shmangies nga ndjekja penale, të cilat mund të zbatohen njëkohësisht, përfshijnë drejtësinë restauruese dhe programet e ndërmjetësimit, këshillimin e fëmijës dhe familjes, paralajmërimin verbal dhe me shkrim, masat e detyrueshme, vendosjen në kujdestari³¹. Në kuadër të programit të drejtësisë restauruese, fëmijës mund t'i kërkohet të pranojë dhe të tregojë mirëkuptim për përgjegjësinë për veprën penale dhe pasojat për viktimën; të kompensojë dëmin e shkaktuar viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë; t'i kërkojë falje viktimës; si dhe të ndërmarrë veprime të pranuar nga viktimja ose/dhe komuniteti³².

Si masë e detyrueshme, fëmija mund:

Të ndalohej

- të kontaktojë apo takojë një person të caktuar,
- të shkojë apo të vizitojë një vend të caktuar,
- të ndryshojë vendbanimin,
- të largohet nga shtëpia gjatë një periudhe/kohe të caktuar,
- të largohet nga një vendndodhje ose një njësi e caktuar administrative pa leje,
- të kryejë veprime të tjera që janë pengesë për risocializimin dhe rehabilitimin e tij.

²⁸ Raport Informativ i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, qershor 2022, f. 6. Gjetet në <https://www.sherbimiproves.gov.al/wp-content/uploads/2022/08/RAPORT-QERHOR-2022.pdf>

²⁹ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 823 datë 24.12.2021 Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025, Objektiv i Specifik 3.4, f. 69.

³⁰ https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/Plani-i-Integritetit_Sherbimi-i-Proves.pdf, f.10-11.

³¹ Kodi i Drejtësisë për Fëmijët, Neni 62.

³² Kodi i Drejtësisë për Fëmijët, Neni 63 (4).

Si masë e detyrueshme, fëmija mund:

X Të detyrohet

- të fillojë ose të rifillojë studimet në një institucion arsimor,
- të fillojë punë në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës,
- të marrë pjesë në programe edukative, korrektuese dhe/ose trajtimi mjekësor,
- të përmbushë detyrime të tjera që lehtësojnë risocializimin dhe rehabilitimin, si dhe e pengojnë të rikryejë veprën penale.

Në nivel qendror Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbështetjes Sociale dhe Ministria e Punëve të Brendshme janë përgjegjëse për zbatimin e masave alternative, ndërsa në nivel vendor bashkitë dhe njësitë e tyre administrative, drejtoria rajonale e shërbimit social shtetëror, njësia e mbrojtjes së fëmijëve në bashki dhe institucione të tjera³³. Roli i Shërbimit të Provës është të mbikëqyrë përmbushjen e masave alternative dhe, sipas parimit të interesit më të mirë të fëmijës, t'i japë fëmijës në konflikt me ligjin asistencë sociale, edukative, psikologjike, mjekësore dhe fizike në përputhje me nevojat individuale dhe moshën, gjininë dhe personalitetin e tij/saj, me qëllim rehabilitimin dhe riintegrimin në jetën shoqërore.³⁴

Shërbimi i Provës bashkëpunon ngushtë me Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve të bashkive ku jeton fëmija, në bazë të memorandumit të marrëveshjes ndërmjet ministrit të Drejtësisë dhe kryetarëve të bashkive përkatëse. Nëse është e nevojshme, Shërbimi i Provës e referon fëmijën nën mbikëqyrje në institucione të tjera publike ose OJF përgjegjëse për zbatimin e masave alternative, si njësia arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar, arsimin e detyrueshëm dhe formimin profesional, shkollat, shërbimet e shëndetit mendor, institucionet e kujdesit shëndetësor (specialistë shëndetësorë, mjekë spitali, mjekë familjar) ose zyrën vendore të punësimit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit³⁵. Megjithatë, Shërbimi i Provës ka raportuar se ka vështirësi në ushtrimin e detyrës për shkak të shërbimeve të pamjaftueshme dhe të paqëndrueshme fiziko-sociale në nivel vendor, mungesës së qendrave për trajtimin psikologjik të dhunës në familje apo qendrave për trajtimin e personave të dënuar të varur nga narkotikët, drogat e forta ose alkooli në nivel vendor³⁶.

Shërbimi i Provës zhvillon takimin e parë me fëmijën brenda 7 ditëve nga data e marrjes së kërkesës nga gjykata ose prokurori, në prani të mbrojtësit të tij, prindit ose kujdestarit ligjor dhe i informon për të drejtat dhe detyrimet gjatë procesit të mbikëqyrjes³⁷.

³³ VKM nr. 207 datë 10.4.2019 "Për përcaktimin e organeve kompetente dhe procedurën që duhet ndjekur për përmbushjen e disa detyrimeve të dhëna nga gjykata për shkelësin e mitur".

³⁴ Ligji për Shërbimin e Provës, Neni 25.

³⁵ VKM nr. 207 datë 10.4.2019 "Për përcaktimin e organeve kompetente dhe procedurën që duhet ndjekur për përmbushjen e disa detyrimeve të dhëna nga gjykata për shkelësin e mitur".

³⁶ Raport informativ i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, qershor 2022, f. 6 gjendet në <https://www.sherbimiproves.gov.al/wp-content/uploads/2022/08/RAPORT-QERSHOR-2022.pdf>

³⁷ Ibid.

Shërbimi i Provës përgatit një plan individual trajtimi bazuar në vlerësimin e sjelljes së fëmijës, personalitetin e tij, kushteve familjare, natyrës së veprës penale të kryer dhe rrethanave të tjera³⁸. Plani individual i trajtimit hartohet në bashkëpunim me fëmijën, prindërit ose kujdestarët ligjorë dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijës, ndërsa nënshkruhet nga kujdestari ligjor i fëmijës dhe avokati mbrojtës³⁹. Oficeri i shërbimit të provës mban kontakte të rregullta me fëmijën gjatë periudhës së mbikëqyrjes.

Disa mjete të përdorura nga Shërbimi i Provës, si Raporti Individual i Vlerësimit, Raporti i Mospërmbyshjes së Masave të Shmangies, Plani Individual i Trajtimit dhe Mjeti i Vlerësimit të Rrezikut, janë hartuar në kuadër të Programit shqiptaro-suedez për Drejtësinë për të Miturit⁴⁰. Në të njëjtën kohë, Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021-2025 parashikon marrjen e masave të nevojshme për zhvillimin e metodologjive, udhëzimeve dhe standardeve të reja në lidhje me mbikëqyrjen (menaxhimi i çështjeve individuale dhe mbikëqyrja elektronike) dhe konsolidimin e metodologjive të monitorimit dhe protokolleve, si dhe funksionimin e tyre në të gjithë territorin⁴¹. Prandaj, shteti parashikon përmirësim të vazhdueshëm të qasjes metodologjike të Shërbimit të Provës.

1.5. Shërbimi i provës për fëmijët në konflikt me ligjin sipas shifrave

Më 31 prill 2022, sipas shifrave të dhëna nga Shërbimi i Provës, në të gjithë territorin e Shqipërisë ndodheshin nën mbikëqyrje 266 fëmijë në konflikt me ligj (tabela më poshtë tregon shpërndarjen gjeografike të këtyre të dhënave). Deri më 31 prill 2022 janë proceduar penalisht për vepra të vjedhjes 114 nga 266 fëmijë nën mbikëqyrje, 40 fëmijë për drejtimin e automjeteve në mënyrë të papërshtatshme dhe 18 për prodhim dhe shitje të narkotikëve. Kanë ndodhur edhe disa raste të plagosjes së rëndë me dashje, detyrimit me shantazh ose dhunë për dhënien e pasurisë dhe mbajtje, blerje ose shitje pa leje të armëve të ftohta. Në 226 raste dënimi alternativ ishte me pezullim (neni 59 i Kodit Penal), në 28 raste ishte punë në komunitet (neni 63 i Kodit Penal), dhe në pjesën tjetër ishte izolim në shtëpi (Neni 59/a i Kodit Penal) dhe burg i hapur (Neni 58 i Kodit Penal). Masa të tjera shmangëse – masa alternative për mosfillimin, pezullimin ose pushimin e procedimit penal ndaj fëmijës në konflikt me ligjin – janë zbatuar në 7 raste. Për sa i përket personelit, është e rëndësishme të përmendet se Shërbimi i Provës nuk ka një strukturë të veçantë për të mbikëqyrur fëmijët në konflikt me ligjin dhe as ndonjë rregull të duhur për caktimin e oficerit të provës për t'u marrë me fëmijët. Kohët e fundit, në Shërbimin e Provës ka pasur një konsensus që drejtori i degës territoriale të emërojë të njëjtin oficer për t'u marrë me fëmijët nën mbikëqyrje, por përsëri duhet të merren me rastet e të rriturve në provë⁴².

³⁸ Kodi i Drejtësisë për Fëmijët, Neni 107.

³⁹ Ligji për Shërbimin e Provës, Neni 23 (1)-(3).

⁴⁰ <https://www.sherbimiproves.gov.al/programi-shqiptar-suedez-i-drejtësisë-penale-per-te-mitur-2/>

⁴¹ VKM nr. 823 datë 24.12.2021 Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025, Objektivi Specifik Nr. 3.4, f. 69.

⁴² Almir Xhangolli: Shërbimi i Provës në Evropë, Shqipëri, CEP, Konfederata e Shërbimit Evropian të Provës, 2021, f. 24 gjendet në <https://www.cep-probation.org/wp-content/uploads/2021/11/Chapter-Albania-final-1.pdf>

Që nga maji 2022, sipas informacionit të dhënë nga Shërbimi i Provës, në kryeqytet dhe në 22 degët territoriale ishin të punësuar 86 oficerë të provës, që do të thotë se numri mesatar i rasteve të një oficeri është më shumë se 110 të dënuar në provë (përfshirë si të rriturit ashtu dhe fëmijët)⁴³.

Degët territoriale të Shërbimit të Provës	Numri i fëmijëve nën mbikëqyrje (mashkull)	Numri i fëmijëve nën mbikëqyrje (femër)	Numri i përgjithshëm i fëmijëve nën mbikëqyrje	Numri i oficerëve të provës
Dega territoriale e shërbimit të provës në Tiranë	98	6	104	25
Dega territoriale e shërbimit të provës në Durrës	40	2	42	5
Dega territoriale e shërbimit të provës në Fier	15	2	17	7
Dega territoriale e shërbimit të provës në Shkodër	12	0	12	8
Dega territoriale e shërbimit të provës në Lezhë	1	0	1	6
Dega territoriale e shërbimit të provës në Elbasan	9	0	9	4
Dega territoriale e shërbimit të provës në Korçë	12	2	14	3
Dega territoriale e shërbimit të provës në Gjirokastrë	2	0	2	2
Dega territoriale e shërbimit të provës në Mat	1	0	1	1
Dega territoriale e shërbimit të provës në Vlorë	15	1	16	4
Dega territoriale e shërbimit të provës në Berat	23	2	25	4
Dega territoriale e shërbimit të provës në Kukës	4	0	4	2
Dega territoriale e shërbimit të provës në Pogradec	1	1	2	1
Dega territoriale e shërbimit të provës në Lushnjë	5	0	5	4
Dega territoriale e shërbimit të provës në Kurbin	0	0	0	1
Dega territoriale e shërbimit të provës në Krujë	2	0	2	2
Dega territoriale e shërbimit të provës në Pukë	1	0	1	1
Dega territoriale e shërbimit të provës në Sarandë	4	0	4	2
Dega territoriale e shërbimit të provës në Kavajë	3	0	3	1
Dega territoriale e shërbimit të provës në Dibër	2	0	2	1
Dega territoriale e shërbimit të provës në Tropojë	0	0	0	1
Dega territoriale e shërbimit të provës në Përmet	0	0	0	1
Total	250	16	266	86

⁴³ Raport Informativ i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës prill-maj 2022, f. 4 gjendet në: <https://www.sherbimiproves.gov.al/wp-content/uploads/2022/06/Raport-Prill-Maj-2022.pdf>

2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

2.1. Mbrojtja e fëmijëve gjatë hulumtimit

Si delegacion kombëtar i Terre des Hommes, Terre des Hommes në Shqipëri udhëhiqet nga Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve e organizatës për të garantuar që në të gjitha aktivitetet e saj fëmijët të gëzojnë përfitimin e një mjedisi mbrojtës dhe të respektohen të drejtat e tyre. Kjo politikë synon të rregullojë punën e organizatës në mënyrë që fëmijët me të cilët Tdh bie në kontakt (drejtpërsëdrejti ose indirekt) të mbrohen dhe të promovohet mirëqenia e tyre, dhe veprimet e organizatave – gjatë zbatimit të programeve ose aktiviteteve institucionale – të mos shkaktojnë ndonjë dëm për fëmijët⁴⁴. Hulumtimi që përfshin fëmijët është një nga këto aktivitete, prandaj Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve e Tdh-së është zbatuar për këtë projekt hulumtues pjesëmarrës.

Të gjithë profesionistët e përfshirë në këtë projekt hulumtues lexuan, kuptuan dhe nënshkruan Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Kodin Global të Sjelljes të Terre des Hommes, si dhe ranë dakord t'i përmbahen atyre në të gjitha veprimet e tyre. Pika e kontaktit për mbrojtjen e fëmijëve në Tdh Shqipëri shërbeu si pikë kontakti edhe për këtë hulumtim. Mbrojtja e fëmijëve të përfshirë në hulumtim u garantua veçanërisht duke siguruar informacionin e duhur për metodat e hulumtimit dhe masat mbrojtëse, si dhe duke kërkuar pëlqimin nga fëmijët dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë, në përputhje me rregulloret kombëtare të Shqipërisë për mbrojtjen e fëmijëve. Në rastin e të rinjve të rritur që marrin pjesë në hulumtim, është ndjekur ligji kombëtar për mbrojtjen e të dhënave dhe rregulloret e tjera përkatëse.

Është e rëndësishme të përmendet se fëmijët e përfshirë në hulumtim ishin veçanërisht të cenueshëm në disa mënyra. Së pari, shumicës së fëmijëve që bien në konflikt me ligjin, u mungon kujdesi dhe vëmendja për të cilën kanë nevojë nga familja e tyre, për shkak të mbikëqyrjes dhe disiplinës së dobët të prindërve, neglizhencës, abuzimit ose braktisjes, dhunës brenda familjes ose anëtarëve të familjes të përfshirë në krim ose varësi. Ndonjëherë ata i përkasin një pakice kombëtare dhe përjetojnë paragjykime, diskriminim, përjashtim social dhe marginalizim që në moshë të re. Këto vështirësi shpesh shoqërohen me mosarritje akademike, braktisje të shkollës, varësi, varfëri ose rritje në lagje të privuara, ku ka një incidencë të lartë të krimit. Së dyti, hyrja në konflikt me ligjin është një përvojë traumatike për fëmijën: arrestimi, marrja në pyetje, ndalimi, komunikimi me autoritetet, ndjenja e humbjes së pushtetit dhe sigurisë janë të gjitha ngjarje stresuese. Prandaj, të flasësh për mënyrën se si dikush bie në konflikt me ligjin mund të jetë nxitës dhe të shkaktojë ritraumatizimin.

Megjithatë, cenueshmëria e fëmijëve nuk duhet të përcaktojë përfshirjen ose përjashtimin e tyre nga hulumtimi, por më tepër të informojë se si mund të bëhet pjesëmarrja e tyre⁴⁵. Duke e vënë në praktikë këtë qasje, çdo dilemë që lindte gjatë hulumtimit mes qasjes proteksioniste dhe pjesëmarrëse u morr në

⁴⁴ Politika Mbrojtëse e Tdh-së gjendet në <https://www.terredeshommes.org/wp-content/uploads/2017/08/TDH-Child-Safeguarding-Policy.pdf>

⁴⁵ Graham, A., Powell, M., Taylor, N., Anderson, D. & Fitzgerald, R. (2013). Hulumtimi etik që përfshin fëmijët. Firence: Zyra e Hulumtimeve të UNICEF-it - Innocenti. F. 24.

konsideratë me kujdes nga mjetet e dialogut, bashkëpunimit dhe reflektimit kritik. Fëmijëve pjesëmarrës në hulumtim iu ofrua qasje në asistencë psikologjike nëpërmjet një personi kontaktues në organizatë, çka u nda me pjesëmarrësit në fund të diskutimit/intervistës në grupin e fokusit.

2.2. Zbatimi i hulumtimit

Hulumtimi është hartuar duke përdorur qasjen pjesëmarrëse; prandaj, burimi kryesor i informacionit ishte planifikuar të përfshinte intervista individuale dhe diskutime në grupe fokusi me fëmijë dhe të rinj që kanë përvojë me mbikëqyrjen dhe shërbimet e Shërbimit të Provës. Burimi tjetër ishte informacioni i marrë përmes hulumtimit dytësor që mbulonte kuadrin ligjor ndërkombëtar dhe kombëtar, publikimet përkatëse, raportet dhe dokumentet e tjera, si dhe informacionet e ofruara nga Shërbimi i Provës sipas kërkesës.

Shërbimi i Provës, dhe konkretisht oficerët e provës, ishin pikat e kontaktit midis hulumtuesve dhe fëmijëve: ata ndanë një thirrje të hapur për pjesëmarrje në hulumtim dhe lidhën fëmijët/të rinjtë e interesuar dhe familjet e tyre drejtpërdrejt me Tdh në Shqipëri. Në përputhje me qasjen për të drejtat e fëmijëve dhe konsideratat mbrojtëse, pjesëmarrësit u informuan dhe kuptuan kuadrin dhe qëllimet e hulumtimit, si dhe dolën vullnetarë për të marrë pjesë në proces. Në rastin e pjesëmarrësve nën moshën 18 vjeç, u informuan prindërit ose kujdestarët ligjorë që dhanë pëlqimin e tyre me shkrim, në përputhje me legjislacionin kombëtar. Që nga momenti i përzgjedhjes së pjesëmarrësve dhe gjatë gjithë procesit, të dhënat personale u trajtuan me kujdes dhe konfidencialitet, në përputhje me rregulloret kombëtare për mbrojtjen e të dhënave.

Edhe pse fëmijëve dhe të rinjve të interesuar iu ofrua të zgjidhnin midis opsioneve të pjesëmarrjes në një intervistë individuale ose në një diskutim në grup fokusi, përfundimisht të gjithë preferuan mjedisin e grupit të fokusit. Duke qenë se numri i aplikantëve dukej i menaxhueshëm, të gjithë u pranuan dhe nuk u zbatua asnjë kriter tjetër. Gjatë realizimit të këtij studimi, nga stafi përgjegjës, janë realizuar 8 fokus grupe në të gjithë shtrirjen territoriale të përcaktuar paraprakisht, me një kohëzgjatje rreth 2.5 orë për secilin grup. Të gjitha diskutimet ndoqën të njëjtën metodologji dhe rend të sesioneve të përgatitura nga konsulenti ndërkombëtar në bashkëpunim me ekspertët kombëtarë dhe Tdh në Shqipëri (shih Shtojca 2). Prindërit e fëmijëve pjesëmarrës dhe përfaqësues të Shërbimit të Provës ishin të pranishëm në fillim të fokus grupit, kur moderatorët shpjeguan qëllimet dhe kornizën e hulumtimit. Më pas, vetëm dy anëtarë të stafit qëndruan në dhomë – një koleg që lehtësoi diskutimin dhe një tjetër që mbajti shënime – dhe pjesëmarrësit u siguruan që gjithçka që diskutohej në fokus grupin do të mbahej konfidenciale.


2.3. Profili i pjesëmarrësve

Profili i pjesëmarrësve që do të përfshiheshin në hulumtim u përcaktua nga qëllimi i tij: fëmijët në konflikt me ligjin që përfitojnë nga shërbimet e Zyrës së Provës dhe për këtë arsye mund të ndajnë perceptimin e tyre mbi efektivitetin dhe ndikimin në rehabilitimin e tyre. Kodi i Drejtësisë Penale për Fëmijët përkufizon “fëmijë në konflikt me ligjin” çdo person që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale deri në moshën 18 vjeç, ndaj të cilit ekziston dyshimi i arsyeshëm për të besuar se fëmija ka kryer një vepër penale, është thirrur si i pandehur dhe/ose fëmija është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale (Neni (3) 4). *Mosha minimale e përgjegjësisë penale* është 14 vjeç në rast kryerjeje të një krimi dhe 16 vjeç në rast të kryerjes së kundërvajtjeve, ndërsa disa dispozita të Kodit të Fëmijëve zbatohen për të pandehurit e moshës madhore (18 deri në 21 vjeç), nëse kanë kryer një vepër penale kur kanë qenë fëmijë. Sipas Ligjit për Shërbimet e Provës, fëmija përfitues i shërbimeve të provës është “i mitur i mbikëqyrur”, person nën moshën 18 vjeç, i cili ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale dhe ndaj të cilit organi kompetent i sistemit të drejtësisë penale për fëmijët ka urdhëruar masë alternative ose dënim jo me burg (Neni (3) 4).

Prandaj, grupi kryesor i synuar ishin fëmijët e moshës 14 deri në 18 vjeç, të cilët aktualisht mbikëqyren nga Shërbimi i Provës. Duke pasur parasysh se kalimi në moshën madhore është një proces, u ftuan të merrnin pjesë edhe të rinj të moshës 18 deri në 21 vjeç, mbikëqyrja e të cilëve nga Shërbimet e Provës ka nisur kur ishin ende nën 18 vjeç. Meqenëse një nga qëllimet e hulumtimit është të analizojë perceptimin e fëmijëve se çfarë ndikimi ka pasur Shërbimi i Provës në riintegrimin dhe rehabilitimin e tyre, të rinjtë deri në moshën 25 vjeç që kanë përfituar nga shërbimet e provës në fëmijëri, por mbikëqyrja e të cilëve ka përfunduar, morën gjithashtu pjesë në hulumtim.


Gjithsej, 32 pjesëmarrës morën pjesë në diskutimet e grupeve të fokusit të moshës 15-21 vjeç, ndërsa shumica e tyre ishin 16-18 vjeç. Perspektiva e të rinjve të rritur ishte veçanërisht interesante, sepse ata mund të ndanin përvojën e tyre në lidhje me trajtimin e fëmijëve dhe të rriturve dhe të reflektonin mbi ngjashmëritë dhe dallimet. Të gjithë pjesëmarrësit raportuan se jetonin në shtëpi me familjen e tyre, prandaj asnjëri prej tyre nuk ishte vendosur në përkujdesje alternative. Për sa i përket profesionit të tyre, shumica ende vijnë në shkollën (18), rreth një e treta e ka braktisur shkollën (10) dhe pak prej tyre tashmë punojnë (4). Pjesëmarrësit vinin nga 8 degë të ndryshme territoriale të Shërbimit të Provës: 8 nga Vlora, 5 nga Durrësi dhe Fieri, 4 nga Berati dhe Shkodra, 3 nga Tirana, 2 nga Korça dhe 1 nga Kukësi. Mbulimi i mirë gjeografik ka qenë një kusht i rëndësishëm për të identifikuar çështjet sistematike të pranishme në degë të ndryshme të institucionit.

Mosha e pjesëmarrësve (numri i përgjithshëm:




Hulumtimet e mëparshme kanë treguar se fëmijët në konflikt me ligjin janë kryesisht nga një prejardhje vulnerabël ose e pafavorizuar, prandaj u mendua se të ftuarit e fëmijëve përfitues të shërbimeve të provës do të krijonte një grup të larmishëm, pa vendosur ndonjë kërkesë apo kusht tjetër për pjesëmarrje. Megjithatë, duke qenë se hulumtimi synonte një grup të mirëpërcaktuar, kampioni nuk pasqyroi dot diversitetin e popullsisë (fëmijë) të Shqipërisë. Vetëm 1 nga 32 pjesëmarrësit ishte femër, që është një përfaqësim 3% në kampion dhe i krahasueshëm me të dhënat e ofruara nga Shërbimi i Provës që tregojnë se 6% e fëmijëve nën mbikëqyrje janë femra (shih Kapitulli 1.5). Për më tepër, 4 pjesëmarrës u identifikuan se i përkisnin një pakice kombëtare, 3 prej tyre me prejardhje migrante dhe 2 deklaruan se kishin nevoja të veçanta ose paaftësi. Shkalla e ulët e diversitetit është marrë parasysh gjatë analizës së të dhënave në lidhje me pyetjet përkatëse hulumtuese, siç është mbrojtja nga diskriminimi.

Diversiteti i pjesëmarrësve (numri i përgjithshëm: 32)



Në momentin e kryerjes së diskutimeve në grupet e fokusit, 30 nga 32 pjesëmarrësit ishin ende nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës: perioda e mbikëqyrjes ndryshon nga 3 deri në 36 muaj. 2 pjesëmarrës ishin të rinj, mbikëqyrja e të cilëve tashmë kishte përfunduar pas një periudhe prej 18 dhe 32 muajsh, respektivisht. 29 pjesëmarrës raportuan se ishin nën mbikëqyrje për herë të parë, ndërsa 3 prej tyre i ishin nënshtruar ndërkohë disa procedurave penale. Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit kishin të njëjtin oficer të provës gjatë gjithë periudhës së mbikëqyrjes (31) dhe raportuan se kishin një marrëdhënie përgjithësisht të mirë me ta (30).

Specifika procedurale (numri i përgjithshëm: 32)



3. PERCEPTIMI I FËMIJËVE NË KONFLIKT ME LIGJIN PËR EFEKTIVITETIN DHE NDIKIMIN E SHËRBIMIT TË PROVËS NË REHABILITIMIN E TYRE

3.1. E drejta e pjesëmarrjes

Kodi i Drejtësisë për Fëmijët deklaron të drejtën e fëmijëve për t'u informuar dhe për të marrë pjesë në çdo vendimmarrje që i prek ata në të gjitha fazat e procedurës penale, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tyre. Informacion "nënkupton çdo të dhënë që është e përshtatshme për moshën dhe pjekurinë e fëmijës dhe që i jepet fëmijës për të ushtruar plotësisht të drejtat e tij, përveç rastit kur dhënia e një informacioni të tillë është në kundërshtim me interesin më të mirë të fëmijës".⁴⁶ E drejta për pjesëmarrje përfshin "të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar dhe për të shprehur pikëpamjet e veta, të cilave u jepet pesha e duhur në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës. Kur një fëmijë kërkon të dëgjohet, kërkesa pranohet, përveç arsyeve të rëndësishme që janë të arsyetuara në vendimin përkatës". Në rast se fëmija nuk është në gjendje ta ushtrojë këtë të drejtë, ata mund ta bëjnë këtë nëpërmjet përfaqësuesve të tyre ligjorë, për më tepër, nëse ka një kontradiktë midis pretendimit të fëmijës dhe përfaqësuesit të tyre ligjor, autoritetet përkatëse duhet të marrin në konsideratë atë që është në interesin më të mirë të fëmijës.⁴⁸

Përgjegjësia penale kërkon një nivel të caktuar pjekurie dhe kuptimi të pasojave të veprimeve të dikujt. Kjo mund të shpjegojë pse ligji i konsideron fëmijët si agjentë aktivë dhe bashkëpunëtorë në procesin e mbikëqyrjes. Shërbimi i Provës është përgjegjës për të informuar për të drejtat dhe detyrimet që ka fëmija gjatë procesit të mbikëqyrjes dhe përfshirjen e tij në hartimin e planit individual të trajtimit.⁴⁹ Shërbimi i Provës duhet të njoftojë gjithashtu fëmijën për pasojat e mospërbushjes së detyrimeve dhe rregullave të shqyrtimit në raste të tilla.⁵⁰ Pjesëmarrja nuk është detyrim; prandaj, mospjesëmarrja nuk duhet ta përkeqësojë pozitën e fëmijës dhe nuk duhet të përdoret në disfavor të tij.⁵¹ Kërkesa për përdorimin e qasjes miqësore ndaj fëmijëve zbatohet për përmbajtjen dhe formatin e informacionit që i jepet fëmijës, si dhe për të gjitha veprimet e kryera nga autoritetet kompetente në prani të fëmijës gjatë procedurës penale, duke përfshirë mbikëqyrjen e masave alternative.⁵²

Të jesh në gjendje të ndikosh në vendimet në lidhje me fëmijën nënkupton që, për më tepër, ata kanë të drejtën e qasjes në mekanizmat përkatës të pavarur dhe efektivë të ankesave. Sipas Ligjit për Shërbimet e Provës, fëmija nën mbikëqyrje ka të drejtën e ankesave administrative dhe gjyqësore kundër veprimeve të oficerit të provës të caktuar për mbikëqyrjen e tij. Ankimi administrativ i paraqitet fillimisht drejtorit të degës territoriale, ku ushtron funksionin Oficeri i shërbimit të provës dhe më pas Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.

⁴⁶ Kodi i Drejtësisë për Fëmijët, Neni 3.

⁴⁷ Ibid. Neni 16 (1).

⁴⁸ Ibid. Neni 16 (7).

⁴⁹ Ligji për Shërbimet e Provës, Neni 25 (3.c-d).

⁵⁰ Ibid. Neni 25 (5).

⁵¹ Kodi i Drejtësisë për Fëmijët, Neni 16 (3).

⁵² Kodi i Drejtësisë për Fëmijët, Neni 16 (5) dhe Neni 19 (3.b).

Kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës, fëmija ka të drejtë të ankohet në prokurori ose në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit në fuqi për ekzekutimin e dënimeve penale⁵³.


Në diskutimin e grupit të fokusit, pjesëmarrësit treguan se kishin një ide të turbullt, të paqartë, për rolin dhe kompetencën e Shërbimit të Provës dhe oficerëve të provës. Në disa raste, pjesëmarrësit shfaqën konfuzion në lidhje me dallimin midis gjykatës dhe Shërbimit të Provës. Ata e kuptonin detyrimin për të marrë pjesë në takime me oficerin e provës, por nuk njihnin gjithë gamën e shërbimeve dhe asistencës që mund të kërkonin ose përfitonin. Me sa duket, shumica e informacioneve për procedurën penale, veprën penale dhe dënimin jepen nga gjyqtari që merr pjesë në çështjen e tyre. Ishte një vëzhgim i përgjithshëm, nga të gjitha diskutimet e grupeve të fokusit, që pjesëmarrësve nuk u kujtoheshin të drejtat që u takonin gjatë procesit të mbikëqyrjes. Disa raportuan se ishin informuar verbalisht në fillim të procesit nga Oficeri i shërbimit të provës, por asnjëri prej tyre nuk përmendi përdorimin e materialeve të përshtatshme për fëmijët, si fletëpalosjet ose udhëzuesit që mund të rishikohen në çdo kohë më vonë gjatë procesit ose që janë të disponueshme publikisht (për shembull në faqen e internetit të institucionit). Nuk u përmend as praktika e zakonshme e përdorimit të gjuhës miqësore për fëmijët dhe pyetjeve vijuese që synojnë të konfirmojnë se fëmija e kuptoi informacionin.

“*Nuk mbaj mend të jem informuar për të drejtat dhe detyrimet e mia”.*
Pjesëmarrës nga Fieri”

“*Në fillim mbaj mend që kam pasur një bisedë me oficerin e shërbimit të provës për procedurat që do të ndiqja. Që atëherë nuk kam marrë asnjë udhëzim për këtë”.*
Pjesëmarrës nga Berati”

Për më tepër, pjesëmarrësit dukej se kishin mungesë serioze njohurish në lidhje me fazat e ndryshme të procesit të mbikëqyrjes, veprimet dhe vendimet e Shërbimit të Provës dhe procedurat institucionale. Termat “raport vlerësimi” dhe “plan individual i trajtimit” ishin të njohur për pjesëmarrësit, por ata nuk ishin në gjendje t'i përkufizonin ose shpjegonin ato, për më tepër, nuk u kujtohej procesi se si u hartuan këto dokumente dhe cila ishte përmbajtja e saktë e tyre në rastet e tyre personale. Disa të rinj në moshë madhore raportuan se kishin nënshkruar letra pa u informuar për përmbajtjen, çka duket se është vazhdimësi e praktikës kur përfaqësuesit ligjorë nënshkruajnë në emër të fëmijëve pa shpjegime për dokumentin dhe pa u konsultuar në lidhje me vendimin që përmban. Duket se është e zakonshme që fëmijët nuk informohen dhe nuk përfshihen në vendimmarrjen në lidhje me ta, ndërkohë që konsiderohen mjaftueshëm të pjekur për t'u quajtur penalisht përgjegjës.

⁵³ Ligji për Shërbimet e Provës, Neni 33.



Mjedisi miqësor për fëmijët, për sa i përket mjedisit fizik, është një kusht i rëndësishëm për të siguruar pjesëmarrjen kuptimplotë të fëmijëve. Në kuadrin e drejtësisë penale, hapësirat miqësore për fëmijët janë edhe më domethënëse, pasi sigurojnë ndarjen e fëmijëve në konflikt me ligjin nga të pandehurit e rritur, si dhe garantojnë mbrojtjen e privatësisë së tyre. Ishte një vëzhgim i përbashkët, i ndarë nga shumica e pjesëmarrësve, se mjediset e Shërbimit të Provës nuk janë të përshtatshme për të kryer intervista dhe seanca miqësore me fëmijët. Për më tepër, asnjë nga pjesëmarrësit nuk përmendi mjedise apo dhoma specifike të dedikuara për fëmijët përfitues brenda mjediseve të Shërbimit të Provës apo ndonjë agjencie tjetër bashkëpunuese.

Pjesëmarrësit nuk ishin në dijeni të së drejtës së tyre për të paraqitur ankesë kundër veprimeve të oficerit të provës të caktuar për mbikëqyrjen e tyre sipas Ligjit për Shërbimet e Provës⁵⁴, për më tepër, nuk kishin informacion në lidhje me ndonjë procedurë ankimi të disponueshme në kuadër të shërbimeve të provës. Në çdo rast, disa nga pjesëmarrësit shprehën skepticizëm nëse një ankesë e tillë do të merrej seriozisht nga autoritetet. Në mënyrë të ngjashme, asnjëri prej tyre nuk përmendi pjesëmarrjen në ndonjë shqyrtim apo vlerësim të shërbimeve të Shërbimit të Provës apo se u janë kërkuar komente për ndonjë prej tyre. Me sa duket, fëmijët nuk i sfidojnë këto dinamika, nuk flasin, nuk ngrenë pyetje, nuk kërkojnë informacion dhe nuk shprehin pikëpamjet e tyre. Fëmijët nuk konsiderohen dhe nuk trajtohen si bartës të plotë të të drejtave, si subjekte aktive në planifikimin, ofrimin dhe vlerësimin e shërbimeve të provës.

⁵⁴Ligji për Shërbimet e Provës, Neni 33 (1).

3.2. Interesi më i mirë i fëmijës dhe e drejta e zhvillimit harmonik

Sipas Kodit të Drejtësisë për Fëmijët, interesi më i mirë i fëmijës nënkupton “të drejtën e fëmijës për një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror, social dhe të drejtën për të gëzuar jetën familjare dhe shoqërore të përshtatshme për fëmijën”⁵⁵. Për më tepër, ai përcakton se interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata parësore për të gjitha autoritetet që marrin vendime në fushën e drejtësisë së fëmijëve, të cilat duhet të shpjegohen dhe arsyetohen në çdo vendim⁵⁶. Për të identifikuar interesin më të mirë të fëmijës individual, duhet të merren veçanërisht parasysh nevojat e fëmijës në aspektin e zhvillimit fizik dhe psikologjik, edukimit dhe shëndetit, pikëpamjet e tyre, historia personale dhe marrëdhëniet me prindërit⁵⁷. Ligji për Shërbimet e Provës pohon, duke thënë se “Shërbimi i Provës udhëhiqet nga parimi i interesit më të mirë të fëmijës dhe i ofron të miturit ndihmë sociale, edukative, psikologjike, mjekësore dhe fizike në përputhje me nevojat individuale dhe moshën, gjininë dhe personalitetin e tij/saj, me synim rehabilitimin dhe riintegrimin në jetën shoqërore”⁵⁸.

Ndonëse interesi më i mirë i fëmijës është një nga parimet kryesore të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, si dhe Kodit të Drejtësisë për Fëmijët, vetë koncepti dukej se ishte i panjohur për pjesëmarrësit e grupeve të fokusit. Kjo e bëri të vështirë që ata të mendonin për përcaktimin e interesit të tyre më të mirë nga Shërbimi i Provës. Për më tepër, duke qenë se nuk janë të përfshirë në mënyrë aktive në hartimin e planit individual të trajtimit dhe monitorimin e zbatimit të tij, nuk janë në gjendje të shqyrtojnë nëse shërbimet e provës marrin vendime duke menduar se çfarë është më e mira për ta. Megjithatë, pjesëmarrësit raportuan se janë të kënaqur me mbikëqyrjen si proces dhe zbatimin e masave alternative, duke iu referuar kryesisht komunikimit dhe ndërveprimit të mirë me oficerin e provës.

Duke iu qasur këtij parimi nga këndvështrimi i misionit të Shërbimit të Provës, shumica e pjesëmarrësve pranuan se ndihma e ofruar nga shërbimi i provës, dhe veçanërisht nga oficerët e provës, ka kontribuar pozitivisht në procesin e riintegrimit të tyre. Ata ndanë disa shembuj në lidhje me këtë: në një rast, Oficeri i shërbimit të provës e ndihmoi fëmijën të menaxhonte shpërthimet e zemërimit dhe të përmirësonte aftësitë e ndërveprimit social, në një rast tjetër, oficeri monitoronte performancën akademike dhe sjelljen e fëmijës në kontakt të ngushtë me mësuesit dhe psikologët e shkollës për të siguruar përparimin e tij. Për më tepër, pjesëmarrësit raportuan sukses në ndjekjen e kurseve profesionale dhe gjetjen e një pune të re falë ndihmës së oficerëve të tyre të provës..

⁵⁵ Kodi i Drejtësisë për Fëmijët, Neni 3.

⁵⁶ Ibid. Neni 10 (1), (3), 12 (1) – (2).

⁵⁷ Ibid. Neni 10 (2).

⁵⁸ Ligji për Shërbimet e Provës, Neni 25 (2).

“Oficeri i shërbimit të provës më ka ndihmuar të jem më pak i zemëruar”.
Pjesëmarrës nga Kukësi

“Oficeri i shërbimit të provës ka kontaktuar shpesh me mësuesit e mi dhe psikologun e shkollës”.
Pjesëmarrës nga Kukësi

“Oficeri i shërbimit të provës më ka ndihmuar të gjej një punë”.
Pjesëmarrës nga Tirana

“Oficeri i shërbimit të provës më ka ndihmuar të filloj një kurs si mekanik”.

3.3. Mbrojtja nga diskriminimi

Kodi i Drejtësisë për Fëmijët garanton se të drejtat e fëmijëve në kontakt me ligjin mbrohen nga diskriminimi në disa aspekte: “gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose sociale, shtatzënia, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, statusi familjar ose martesor, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicioni gjenetik, paaftësia, përkatësia në një grup të caktuar dhe çdo situatë e fëmijës, prindërve ose përfaqësuesve ligjorë të fëmijës”⁵⁹. Fëmijët që bien në kontakt me sistemin e drejtësisë penale si persona të dyshuar ose të akuzuar mund të kenë ndërkaq disa karakteristika që i vënë në rrezik diskriminimi ose trajtimi të padrejtë. Duke qenë kështu, për të pasur një pamje të qartë të diversitetit të kampionit, anketa e grupeve para-fokus përfshiu pyetje në lidhje me përkatësinë në grupet e pakicave, të kaluarën në migracion, nevojat e veçanta dhe aftësitë e kufizuara.

Në diskutimet e grupeve të fokusit u ngritën një sërë pyetjesh për të hetuar mbi përvojën e fëmijëve në lidhje me trajtimin e drejtë dhe të barabartë. Të gjithë pjesëmarrësit raportuan se kurrë nuk janë ndier të diskriminuar nga Oficeri i shërbimit të provës për shkak të gjinisë, përkatësisë etnike ose origjinës gjeografike. Edhe pse është një gjetje pozitive, duhet të merret parasysh me kujdes, sepse diversiteti i kampionit ishte mjaft i kufizuar (shih Kapitullin 2.3). Për të njëjtën arsye, nuk mund të nxirret asnjë përfundim nga fakti se asnjë pjesëmarrës nuk përmendi ndonjë ndihmë apo mbështetje të veçantë të marrë nga Shërbimi i Provës për shkak të cënueshmërisë së tyre. Moshë mund të jetë gjithashtu një bazë e mundshme diskriminimi, por duhet theksuar se disa nga fëmijët besonin se kanë marrë trajtim pak më të mirë nga oficerët e provës sesa të rriturit.

⁵⁹ Kodi i Drejtësisë për Fëmijët, Neni 11 (1).

“

*“Jam trajtuar me respekt nga Oficeri i shërbimit të provës.
Nuk jam ndjerë kurrë i gjykuar prej tij”.*

Pjesëmarrës nga Korça

”

3.4. Respekti për dinjitetin dhe mbrojtja e privatësisë së fëmijës

Shërbimi i Provës, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij të përcaktuar me ligj, duhet të respektojë dinjitetin dhe integritetin e të gjithë personave nën mbikëqyrje, përfshirë fëmijët në konflikt me ligjin⁶⁰. Puna me fëmijët, veçanërisht me fëmijët vulnerabël, kërkon tipare të përshtatshme të personalitetit dhe grup specifik aftësish: këto mund të verifikohen gjatë procesit të përzgjedhjes së oficerëve të provës dhe më pas të përmirësohen më shumë përmes trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm. Një aspekt i dinjitetit është privatësia: siç e përcakton Kodi i Drejtësisë për Fëmijët, privatësia e fëmijës duhet të respektohet gjatë gjithë procedurës penale, prandaj asnjë informacion që zbulon identitetin e fëmijës, apo ndonjë e dhënë personale, nuk mund të bëhet publik⁶¹.

Shumica e konsiderueshme e pjesëmarrësve të grupeve të fokusit raportuan se kishin një marrëdhënie përgjithësisht të mirë me oficerin e tyre të provës, se ndiheshin se trajtoheshin me respekt dhe dinjitet. Asnjë prej tyre nuk tregoi ndonjë rast frikësimi, por disa prej tyre përmendën se seanca e parë ishte paksa e pakëndshme. Marrëdhënia e mirë personale mund t'i atribuohet pjesërisht faktit që – përveç një rasti – i njëjti oficer prove e ka shoqëruar fëmijën ose të riun gjatë gjithë procesit. Profesionistët mund të ndërtojnë marrëdhënie të besueshme me fëmijët me kalimin e kohës, prandaj, kjo praktikë e Shërbimit të Provës duhet të mbështetet më tej.

“

“Unë kam një marrëdhënie shumë të mirë me oficerin e provës”.

Pjesëmarrës nga Shkodra

”

“

“Oficeri i shërbimit të provës është i duruar dhe komunikon shumë mirë me mua”.

Pjesëmarrës nga Vlora

”

“

“Oficeri i shërbimit të provës është shumë pozitiv”.

Pjesëmarrës nga Berati

”

“

“Unë kam një bashkëpunim shumë të mirë me oficerin e provës”.

Pjesëmarrës nga Kukësi

”

⁶⁰ Ligji për Shërbimet e Provës, Neni 4 (2).

⁶¹ Kodi i Drejtësisë për Fëmijët, Neni 21 (1)-(4).

3.5. Ekzaminim i shpejtë me preferencë dhe pa vonesa të panevojshme

Në të gjitha proceset ligjore që përfshijnë fëmijët, duhet të zbatohet parimi i shmangies së vonesës së panevojshme, në mënyrë që të sigurohet se do të mbizotërojë interesi më i mirë i fëmijës, duke respektuar sundimin e ligjit. Kodi i Drejtësisë për Fëmijët zbaton këtë parim në procedurën penale që nga fillimi i procedimit deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor: të gjitha vendimet dhe veprimet duhet të merren menjëherë, me preferencë dhe pa vonesa të pajustificuara “duke u siguruar që procesi penal, në çdo fazë, nuk e përkeqëson traumën e përjetuar nga fëmija dhe që sistemi i drejtësisë penale për fëmijët ofron, kur është e përshtatshme, ndihmën e duhur për fëmijën”⁶².

Fëmijët dhe adoleshentët kanë një perceptim të ndryshëm të kohës, prandaj perspektiva e tyre është vendimtare në këtë drejtim. Pjesëmarrësit e grupit të fokusit nuk shprehën ndonjë shqetësim apo përvojë të keqe në lidhje me ekzaminimin dhe menaxhimin e shpejtë të rastit së tyre nga Shërbimi i Provës. Siç u theksua edhe më parë, pa njohuri për të drejtat e tyre dhe procesin e mbikëqyrjes, p.sh., se mbledhja e parë duhet të bëhet brenda 7 ditëve, ata nuk janë në gjejnë të kuptojnë nëse janë respektuar afatet procedurale. Megjithatë, ata nuk ndien ndonjë vonesë të konsiderueshme që mund të ishte e dëmshme për shëndetin mendor ose mirëqenien e tyre. Disa prej tyre përmendën se mendonin se frekuenca e seancave me oficerin e shërbimit të provës ishte mjaft e lartë, por kurrë nuk ia kishin dhënë këtë reagim drejtpërdrejt Shërbimit të Provës.

“

“Oficeri i shërbimit të provës nuk i ka vonuar asnjëherë procedurat me mua”.
Pjesëmarrës nga Tirana

”

3.6. Elementet e procesit të rregullt

Është me rëndësi të madhe që elementet e procesit të rregullt ligjor – të tilla si parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, prezumimi i pafajësisë, e drejta për një gjykim të drejtë, e drejta për këshillim ligjor, e drejta për qasje në gjykata dhe e drejta për ankim – të garantohen për fëmijët në konflikt me ligjin dhe në asnjë rrethanë nuk mund të minimizohen apo mohohen. Kodi i Drejtësisë për Fëmijët e deklaron këtë qasje duke theksuar se fëmijët në konflikt me ligjin gëzojnë të drejtat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, si dhe të drejtat e veçanta të parashikuara në këtë Kod, ndër të tjera, të drejtën për t'u informuar menjëherë, në mënyrë të përshtatshme për zhvillimin e tyre individual, të drejtën për t'u ankuar kundër vendimeve dhe të drejtën për të pasur të pranishëm prindërit e tyre ose personin e besuar, përveç rasteve kur pjesëmarrja e këtij personi nuk është në interesin më të mirë të fëmijës⁶³.

⁶² Kodi i Drejtësisë për Fëmijët, Neni 17.

⁶³ Kodi i Drejtësisë për Fëmijët, Neni 19 (1)-(3).

Në përgjithësi, pjesëmarrësit e patën të vështirë të reflektonin se sa ishin respektuar elementet e procesit të rregullt nga Shërbimi i Provës për shkak të mungesës së njohurive për të drejtat e tyre dhe procedurat institucionale. Siç u zbulua gjatë diskutimeve në grupet e fokusit, mbledhja e informacionit përmes intervistave individuale, përdorimi i mundshëm i testeve të ndryshme psikologjike, përfshirja e anëtarëve të familjes në proces, opinioni për profilin e tyre psikologjik dhe rekomandimet për procesin e integritimit ndodhin të gjitha pa kontributin e ndërgjegjshëm të fëmijëve. Kur fëmijët mbushin 18 vjeç gjatë mbikëqyrjes së tyre, ata befasisht bëhen plotësisht të rritur, të cilët mund të marrin vendime dhe të nënshkruajnë dokumente – gjë që ata nuk ishin të përgatitur ta bënin. Ky duhet të jetë një aspekt themelor i mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në konflikt me ligjin, pasi kalimi në moshën madhore nuk është aq i pazakontë: disa nga pjesëmarrësit e grupeve të fokusit kanë qenë nën mbikëqyrje për 32-36 muaj.

“

“Nuk e di nëse ka një plan integrimi për mua”.

Pjesëmarrës nga Fieri

”

4. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

Ky hulumtim synon të kuptojë perceptimin e fëmijëve në konflikt me ligjin për efektivitetin e Shërbimit të Provës dhe ndikimin në rehabilitimin e tyre në bashkëpunim të ngushtë me Shërbimin e Provës të Shqipërisë. Standardet ndërkombëtare të drejtësisë penale për fëmijët, të garantuara nga Kodi shqiptar i Drejtësisë Penale për të Mitur, shërbyen si bazë e metodologjisë së hulumtimit: e drejta për pjesëmarrje, interesi më i mirë i fëmijës dhe e drejta për zhvillim harmonik, mbrojtja nga diskriminimi, respektimi i dinjitetit dhe mbrojtja e privatësisë së fëmijës, ekzaminimi i shpejtë me preferencë dhe pa vonesa të panevojshme, si dhe elementet e procesit të rregullt ligjor. Të dhënat u mblodhën nëpërmjet diskutimeve në grupe fokusi me fëmijë dhe të rinj që ishin ose kishin qenë nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës, si dhe me kërkime dytësore mbi instrumentet ligjore dhe publikimet përkatëse. Është e rëndësishme të kujtojmë se përfundimet e hulumtimit bazohen në perceptimin e fëmijëve që kanë pasur përvojë me Shërbimin e Provës dhe rekomandimet janë formuluar në mënyrë që t'i bëjnë fëmijët të dëgjohen dhe t'i ndihmojnë të ndikojnë në programet dhe shërbimet që kanë një ndikim të rëndësishëm në jetën e tyre.

Edhe pse e drejta e pjesëmarrjes së fëmijëve në konflikt me ligjin garantohet nga instrumentet ligjore shqiptare, veçanërisht nga Kodi i Drejtësisë për Fëmijët dhe Ligji për Shërbimet e Provës, ka një hendek të madh midis kuadrit ligjor dhe zbatimit të tij në praktikë. Duket se është e zakonshme që fëmijët nuk informohen dhe nuk përfshihen në vendimmarrjen në lidhje me ta, ndërkohë që konsiderohen mjaftueshëm të pjekur për t'u quajtur penalisht përgjegjës. Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit dëshmuuan se kishin një ide të paqartë për rolin dhe kompetencën e Shërbimit të Provës dhe oficerëve të provës, si dhe një mungesë serioze njohurish për procedurat institucionale. Ata nuk i mbanin mend të drejtat që u takojnë gjatë procesit të mbikëqyrjes, as detyrimet e tyre. Veç kësaj, nuk ishin në dijeni të së drejtës së tyre për të paraqitur një ankesë kundër veprimeve të oficerit të provës të caktuar për mbikëqyrjen e tyre, për më tepër, asnjë pjesëmarrës nuk përmendi pjesëmarrjen në një shqyrtim ose vlerësim të shërbimeve të Shërbimit të Provës ose t'u jenë kërkuar komente në ndonjë formë. Ishte një vëzhgim i zakonshëm, i ndarë nga shumica e pjesëmarrësve, se mjediset e Shërbimit të Provës nuk janë të përshtatshme për të kryer intervista dhe seanca miqësore me fëmijët dhe në disa raste, mungesa e mjedisit të dedikuar privat, mund të përbëjë një kërcënim të mundshëm për privatësinë e fëmijës.

Pavarësisht bazës ligjore, fëmijët nuk konsiderohen dhe nuk trajtohen si bartës të plotë të të drejtave dhe si subjekte aktive të përfshira në planifikimin, ofrimin dhe vlerësimin e shërbimeve të provës. Me sa duket, fëmijët nuk i sfidojnë këto dinamika, nuk flasin, nuk ngrenë pyetje, nuk kërkojnë informacion dhe nuk shprehin pikëpamjet e tyre. Edhe disa pjesëmarrës të grupeve të fokusit shprehën skepticizëm nëse pikëpamjet apo opinionet e tyre do të merreshin seriozisht nga autoritetet. Fatkeqësisht, kjo ndikoi ndjeshëm në mënyrën se si pjesëmarrësit reflektuan mbi gëzimin dhe ushtrimin e të drejtave të tjera të tyre të monitoruara nga ky hulumtim. Si shembull, duke qenë se pjesëmarrësit nuk e njihnin konceptin e interesit më të mirë të fëmijës dhe thanë se nuk ishin përfshirë në mënyrë aktive në hartimin e planit individual të trajtimit dhe në monitorimin e zbatimit të tij, nuk ishin në gjendje të vlerësonin nëse

Shërbimi i Provës merr vendime duke menduar se çfarë është më e mira për ta. Në mënyrë të ngjashme, pjesëmarrësit e patën të vështirë të reflektonin se sa ishte respektuar parimi i urgjencës ose elementet e procesit të rregullt nga Shërbimi i Provës, për shkak të mungesës së njohurive për procedurat institucionale.

Vlen të theksohet se pjesëmarrësit u shprehën të kënaqur me mbikëqyrjen si proces dhe zbatimin e masave alternative, duke iu referuar më së shumti komunikimit dhe ndërveprimin të mirë me oficerin e provës, për më tepër, shumica e tyre pranuan se ndihma e ofruar nga oficerët e provës ka kontribuar pozitivisht në procesin e riintegrit të tyre. Edhe pse diversiteti i kampionit ishte i kufizuar, të gjithë pjesëmarrësit raportuan se kurrë nuk janë ndier të diskriminuar nga Oficeri i shërbimit të provës për shkak të gjinisë, përkatësisë etnike ose prejardhjes gjeografike. Bazuar në dëshmitë e fëmijëve dhe të rinjve që morën pjesë në hulumtim, oficerët e provës duket se mbartin tiparet e personalitetit dhe aftësitë e nevojshme për të punuar me fëmijët në konflikt me ligjin. Kjo mund t'i atribuohet procesit të përzgjedhjes dhe trajnimit të tyre, por pa detaje të mëtejshme në lidhje me këto procedura, nuk mund të nxirren përfundime.

Shqetësimi më thelbësor i identifikuar nga ky hulumtim pjesëmarrës që përfshin fëmijë me përvojat e tyre përkatëse është hendeku i rëndësishëm midis deklaratimit të së drejtës së fëmijëve për pjesëmarrje në ligj dhe zbatimin të tij në praktikë në kontekstin e shërbimeve të provës. Fëmijët janë të kënaqur me ndërveprimin e oficerëve të provës, por nuk janë plotësisht të vetëdijshëm për atë që ndodh dhe nuk kontribuojnë me ndërgjegje në të. Duket se oficerët e provës e vënë theksin te vendosja dhe nxitja e një marrëdhënieje pozitive me fëmijën nën mbikëqyrje, ndërkohë që nuk arrijnë të sigurojnë pjesëmarrjen kuptimplotë të fëmijës, çka duhet të jetë një komponent thelbësor i procesit të riintegrit.

Për të mbushur boshllëqet, mund të paraqiten disa rekomandime për vendimmarrësit dhe Shërbimin e Provës:

- Oficerët e provës kanë nevojë për udhëzime se si t'i mbështesin fëmijët në gëzimin dhe ushtrimin e të drejtës së tyre për pjesëmarrje: hartimi i një protokollit të brendshëm nga Shërbimi i Provës do të ishte një mjet i përshtatshëm ndërhyrjeje, në bashkëpunim me përfituesit, fëmijët. Një protokoll i tillë mund të mbulojë të gjitha fazat e procesit të mbikëqyrjes dhe skenarët e ndryshëm të mundshëm kur fëmija i mbikëqyrur duhet të informohet për të drejtat dhe detyrimet e tij, si dhe detajet e çështjes së tij, për më tepër, kur fëmija duhet të përfshihet në vendimmarrje. Përveç kësaj, ai mund të përfshijë mundësi që fëmijët të japin komente mbi shërbimet e marra dhe mënyrat për t'u përfshirë në aktivitetet e vlerësimit.
- Oficerët e Shërbimit të provës duhet të marrin trajnime të vazhdueshme për të drejtën e pjesëmarrjes dhe veçanërisht për zbatimin e protokollit të brendshëm, i cili do të përshtatet me politikën e institucionit për të rishikuar vazhdimisht nevojat për trajnim të stafit dhe në bazë të kësaj, për të përmirësuar aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve. Për më tepër, përfshirja e protokollit të brendshëm në shqyrtimin dhe vlerësimin e rregullt të institucionit do të siguronte ndjekjen e duhur.

- Për të rritur ndikimin pozitiv në riintegrimin e të miturve në konflikt me ligjin, duhet mundësuar bashkëpunimi i të gjithë hallkave, duke filluar nga familja, si bërthamë e shoqërisë, e më tej i institucioneve shtetërore, private, kombëtare e ndërkombëtare.
- Qasja në informacion, si pjesë integrale e së drejtës për pjesëmarrje, mund të sigurohet nga zhvillimi dhe shpërndarja e gjerë e materialeve informative miqësore për fëmijët, të cilat shpjegojnë të drejtat dhe detyrimet e fëmijëve nën mbikëqyrje, procedurat institucionale dhe mekanizmat e disponueshëm të ankesave. Përdorimi i materialeve të tilla do të kontribuonte për zbatimin e suksesshëm të protokollit të brendshëm për pjesëmarrjen e fëmijëve të përshkruar më sipër.
- Paralelisht me zhvillimin organizativ dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit, do të ishte thelbësore që oficerëve të provës t'u sigurohet mbështetje financiare, pajisje dhe infrastruktura e nevojshme, veçanërisht të përmirësohet mjedisi fizik dhe të krijohen hapësira të dedikuara miqësore për fëmijët brenda mjediseve të Shërbimit të Provës ose të krijohet bashkëpunim me autoritetet e tjera, të cilat mund të ofrojnë qasje në strukturat e tyre. Në të njëjtën kohë, kapacitetet e institucionit vendor duhen forcuar për të siguruar një koordinim dhe komunikim më të mirë me Shërbimin e Provës.
- Ndonëse Shërbimi i Provës ka zhvilluar një praktikë për emërimin e të njëjtëve kolegë për mbikëqyrjen e fëmijëve dhe mbajtjen e tyre gjatë gjithë çështjes, krijimi i një departamenti të veçantë, i ngarkuar për t'u marrë ekskluzivisht me fëmijët dhe i pajisur me mjetet e duhura, mund të rriste më tej cilësinë e shërbimeve të provës të ofruara për fëmijët. Duke marrë parasysh rritjen e mundshme të numrit të fëmijëve nën mbikëqyrje, për shkak të numrit më të madh të rasteve të shmangies – që do të thotë se gjithnjë e më shumë fëmijë largohen nga procedura penale – struktura e institucionit ndoshta duhet t'i nënshtrohet së shpejti një riorganizimi.

Shtojca 1. Pyetjet hulumtuese: zbatimi i parimeve të drejtësisë miqësore ndaj fëmijëve në shërbimet e provës

Parimet e drejtësisë miqësore ndaj fëmijëve	Zbatimi në shërbimet e provës
<p><i>Interesi më i mirë i fëmijës dhe e drejta për zhvillim harmonik</i></p>	<p><i>Si është përcaktuar interesi më i mirë i fëmijës nga Shërbimi i Provës në fazat e ndryshme? Si ka ndodhur sipas perceptimit të fëmijës? A ishte fëmija i përfshirë?</i></p> <p><i>A ndikoi përcaktimi i interesit më të mirë të fëmijës në hartimin dhe zbatimin e planit individual të trajtimit?</i></p> <p><i>A ka ndikuar pozitivisht përcaktimi i interesit më të mirë të fëmijës në riintegrimin dhe rehabilitimin e tij?</i></p> <p><i>A kishte ndonjë dilemë në lidhje me përcaktimin e interesit më të mirë të fëmijës? Nëse po, si u zgjidh?</i></p>
<p><i>Pjesëmarrja (e drejta për informim dhe e drejta për t'u dëgjuar)</i></p>	<p><i>A ishte fëmija i informuar dhe e kuptonte rolin dhe kompetencën e Shërbimit të Provës, si dhe procedurën e ndjekur në një gjuhë miqësore për fëmijët?</i></p> <p><i>A ishte fëmija i informuar dhe i kuptonte të drejtat dhe detyrimet e tij në lidhje me shërbimet e provës në një gjuhë miqësore për fëmijët?</i></p> <p><i>A është i disponueshëm publikisht informacioni i përshtatshëm për fëmijët në lidhje me shërbimet e provës (në internet apo në mjedise)?</i></p> <p><i>A ka kërkuar fëmija informacion nga Oficeri i shërbimit të provës gjatë mbikëqyrjes? A ishte i kënaqur me përgjigjen?</i></p> <p><i>Në varësi të moshës, a është vënë në dijeni fëmija për momentet kur mund dhe pritet të marrë një vendim për të ndikuar në shërbimet që merr? A e mori fëmija këtë vendim? A ishin ato të udhëhequra apo mbështetura nga prindërit apo kujdestarët e tyre ligjorë?</i></p> <p><i>A janë dëgjuar fëmijët nga Shërbimi/Oficeri i shërbimit të provës gjatë procesit kur ndanë mendimin apo shqetësimin e tyre?</i></p> <p><i>A është i disponueshëm vlerësimi për fëmijët, mbikëqyrja e të cilëve është ndërprerë nga Shërbimi i Provës? Nëse po, në çfarë forme (p.sh., pyetësor, reagime anonime)?</i></p>

<p><i>Respektimi i dinjitetit dhe mbrojtja e privatësisë së fëmijës</i></p>	<p><i>A është trajtuar fëmija me respekt nga Shërbimi i Provës? A ndihej fëmija i trajtuar me respekt nga shërbimet e provës?</i></p> <p><i>A është marrë në konsideratë nga Shërbimi i Provës ndonjë nevojë e veçantë e komunikuar nga fëmija?</i></p> <p><i>A ndihej fëmija i sigurt dhe i qetë në mjediset e shërbimit?</i></p> <p><i>A është mbrojtur privatësia e fëmijës gjatë gjithë procesit? (Përfshirë trajtimin e të dhënave personale nga shërbimet e provës si zyrë si dhe konfidencialitetin e ndjekur nga oficerët e provës në pozicionin e tyre zyrtar dhe jashtë orarit të punës).</i></p>
<p><i>Mbrojtja nga diskriminimi</i></p>	<p><i>A është identifikuar ndonjë grup fëmijësh që mund të jenë veçanërisht të cenueshëm nga diskriminimi?</i></p> <p><i>Çfarë masash merren për të parandaluar dhe trajtuar diskriminimin që lind gjatë kohës që fëmijët përfitojnë nga shërbimet e provës?</i></p> <p><i>Ku mund të drejtohen fëmijët me ankesat e tyre në lidhje me diskriminimin e pretenduar?</i></p> <p><i>Çfarë masash merren për të ofruar mbështetje dhe ndihmë të veçantë për fëmijët e cenueshëm?</i></p>
<p><i>Ekzaminim i shpejtë me preferencë dhe pa vonesa të panevojshme</i></p>	<p><i>A u trajtua menjëherë dhe pa vonesa të panevojshme rasti i fëmijës (në përputhje me afatet e përcaktuara nga legjislacioni përkatës)?</i></p> <p><i>Sipas perceptimit të fëmijës, a u trajtua çështja me shpejtësi dhe pa vonesë?</i></p> <p><i>A është dëgjuar dhe shqyrtuar menjëherë nga shërbimet e provës ndonjë kërkesë e fëmijës?</i></p> <p><i>Si ka ndikuar koha e shërbimeve të provës që ofrohen për fëmijën në riintegrimin dhe rehabilitimin e tyre?</i></p>
<p><i>Elementet e procesit të rregullt</i></p>	<p><i>A janë respektuar të drejtat e procesit të rregullt të fëmijës nga shërbimet/Oficeri i shërbimit të provës ?</i></p> <p><i>A ishte hartimi dhe zbatimi i planit të trajtimit në përputhje me parimet e procesit të rregullt ligjor?</i></p> <p><i>A ishin fëmijët në dijeni të mekanizmave të apelit dhe ankimit në lidhje me shërbimet e provës? A i kanë përdorur?</i></p>

Shtojca 2. Tabelë me përmbledhjen e seanceve të diskutimeve të grupeve të fokusit

TABELA E SEANCAVE			
Nr.	TITULLI I SEANCËS	QËLLIMI I SEANCËS	KOHËZGJATJA
SEANCA 1	Hyrje në hulumtim	<ul style="list-style-type: none"> • Të prezantojë qëllimin dhe kornizën e hulumtimit, si dhe të informojë pjesëmarrësit për rolin e tyre dhe ndikimin e mundshëm • Të njihen me njëri-tjetrin (lehtësues/pjesëmarrës) • Të vendosë rregullat 	30 minuta
SEANCA 2	Perspektiva e fëmijëve për shërbimet e provës 1.	<ul style="list-style-type: none"> • Të diskutohet e drejta për pjesëmarrje (e drejta për informim dhe e drejta për t'u dëgjuar) në lidhje me shërbimet e provës 	45 minuta
SEANCA 3	Perspektiva e fëmijëve për shërbimet e provës 2.	<ul style="list-style-type: none"> • Të diskutohet se si janë respektuar nga shërbimet e provës interesi më i mirë i fëmijës, respektimi i dinjitetit, privatësisë dhe e drejta për mbrojtje nga diskriminimi 	45 minuta
SEANCA 4	Perspektiva e fëmijëve për shërbimet e provës 3.	<ul style="list-style-type: none"> • Të diskutohen parimet që lidhen me procesin e rregullt dhe shqyrtimin e shpejtë të çështjes • Të skicohet profili i "oficerit ideal të provës" 	45 minuta
SEANCA 5	Seanca përmbyllëse	<ul style="list-style-type: none"> • Të vlerësohet diskutimi i grupit të fokusit si proces me pjesëmarrësit • Të mbyllet diskutimi dhe të përshëndetet grupi 	15 minuta



Terre des hommes

Ndihmë për fëmijët.